



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Mësimdhënia e gjuhës angleze** **(2017/2018)**

Fakulteti	Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Titulli	Magjistër nga mësimdhënia e gjuhës angleze
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-618/3
Numri në arkiv i akreditimit []	03-1619/17 (10.11.20)
Vendimi për fillim me punë	03-1619/17 (10.11.20)
Data akreditimit	21.03.2017

Përshkrimi i programit

Qëllimi i programit Mësimdhënia e gjuhës angleze është që t'i pajisë studentët me njohuri solide nga teoritë e metodologjisë dhe t'i familjarizojë ata me shkathtësitë e nevojshme për t'i vënë në zbatim njëkohësisht edhe teoritë e fituara në praktikën mësimore. Përzgjedhja e lëndëve individuale reflekton trendet e tanishme në mësimin e gjuhës së dytë duke ndihmuar po ashtu edhe identifikimin e nevojave vendore dhe rajonale. Programi është dizajnuar kryesisht për të diplomuar në gjuhën angleze si gjuhë e huaj, respektivisht për ata që dëshirojnë të specializohen dhe të zhvillojnë shkathtësitë e tyre në pedagogjinë e mësimdhënies së gjuhës angleze. Aty përfshihet gjithashtu edhe komponenti i kërkimeve dhe hulumtimeve (ai cilësor dhe sasior së bashku), mandej ai akademik, si dhe "hulumtimet moderne" të kryera vet në klasë.

Karriera

Shumica e studentëve në program duhet të kenë të nisur karrierën (punën) e tyre në mësimdhënie. Për t'ua lehtësuar ndjekjen e orëve, orët janë të parapara të mbahen gjatë fundjavëve, jashtë orarit të zakonshëm të punës. Shumica e lëndëve ofrojnë trajnime të specializuara të cilat instruktorët e anglishtes do t'i vlerësojnë si shumë të dobishme, siç janë: metodologjia e mësimdhënies së gjuhës së huaj, menaxhimi orës, të shkruarit dhe gramatika pedagogjike, mësimi i gjuhës me ndihmën e kompjuterit dhe analiza e nevojave. E gjithë kjo është bazuar në parimet më të shkëlqyera të trajnimit modern të mësimdhënies nga vendet anglishtfolëse të aplikuara në kontekstin ballkanik.

Ndërkohë që ky program është i dizajnuar në mënyrë specifike për nevojat e mësimdhënësve të gjuhës angleze, programi ynë është njëkohësisht efektiv në pajisjen e studentëve me shkathtësi të nevojshme për hulumtime akademike të avancuara, por mund të jetë i dobishëm edhe për ata studentë të cilët duan të bëhen përkthyes, kritikë, botues të ndryshëm ose shkrimtarë.

Programi zhvillohet në katër semestra instruksione mësimi, respektivisht ligjërata, të përcjella me hulumtime, si dhe me shkrimin e tezës së magjistraturës.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka metodologji të avancuar të gjuhës angleze.
- Ka njohuri të thella të teorisë për përfitimin e gjuhës së huaj
- Demonstron njohuri të gramatikës angleze dhe kompozicionit të gjuhës angleze nga pikëpamja pedagogjike.
- E njeh dhe e kupton përdorimin e të mësuarit të gjuhëve me anë të kompjuterit si merr pjesë aktive në përmirësimin e përdorimit të tij.
- Njeh teori të ndryshme pedagogjike në mësimin e të shkruarit.
- Ka njohuri në të shkruarit e punimeve shkencore, prezantimit dhe finesës.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Mëson gjuhën angleze në mënyrë efikase në formën teorike të të informuarit.
- Aplikon parimet për përfitim të gjuhës së dytë / të huaj në mes të klasës me përdorim të metodologjive përkatëse të të mësuarit.
- Dizajnon planprograme mësimore, në forma të përshtatshme për raste konkrete, për shembull, për mësimin e nxënësve më të rinj (ndër 12 vjeçar) apo edhe mësimin e anglishtes së biznesit për të rritur.
- Përdor, adapton dhe krijon materiale adekuate për përdorim, në orën e gjuhës së huaj.
- Përdor teknologjinë në formë efektive, krijon mjete të thjeshta praktike multimediale dhe ueb faqe për përdorim praktik në orët gjuhësore, për shembull lojëra të fjalëve me anë të kompjuterit.

Aftësitë për të vlerësuar

- Shprehin në formë kritike për materialin e mësuar si dhe për eksperiencat në ligjëratë/mësim në orë.
- Identifikojnë vështirësitë potenciale në raport me pyetjet për avancimin e gjuhës amtare, në orët e anglishtes si gjuhë e huaj.
- Përmbledhin materiale adekuate nëpërmjet vetëdijësimit të informuar të nevojave të nxënësve.
- Sjellin vendime në lidhje me vështirësitë potenciale të aspekteve të ndryshme të gjuhës angleze: përcaktimin e kohës dhe foljes, parafjalëve të caktuara/pacaktuara, propozimeve, si dhe kategorive të tjera gramatikore, shprehje idiomatike, kolokacione leksikore dhe formime të fjalës.
- Bëjnë vlerësime të komplikuar metodologjike në dizajnimin hulumtues, si dhe bëjnë dallimin ndërmjet metodave të ndryshme për mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre, që kanë të bëjnë me gjuhën dhe me linguistikën.

Aftësitë e komunikimit

- Të ketë njohuri të shkëlqyeshme të shqiptimit të anglishtes.
- Të jetë në gjendje të prodhojë punime akademike të strukturuar, të qarta dhe të shkruara mirë.
- Të mund t'i prezantojë dhe t'i elaborojë problemet e përbashkëta të cilat janë të kyçura në mësimin dhe mësimdhënien e gjuhës angleze si gjuhë e huaj.
- Të tregojë përgjegjësi komunikative në orë në raport me cilësinë e mësimdhënies, udhëheqjes, si dhe organizimit të orës.

Aftësitë e të mësuarit

- Shpreh iniciativë dhe autonomi në rolin profesional të mësimdhënies.
- Është në gatishmëri që individualisht t'i ndjekë dhe t'i adaptojë metodat e mësimdhënies në pajtueshmëri me situatat e caktuara.
- Është i përshtatshëm gjatë rrethanave të ndryshme kulturore dhe ndërnjerëzore në orët e anglishtes si gjuhë e huaj.
- Inicion dhe përfundon punë të pavarur hulumtuese në kuadër të standardeve të larta akademike në kuadër të afatit të dhënë kohor.
- Demonstron lidërsip dhe aftësi të mësimdhënies në shpërndarjen efektive të njohurive.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [MCEL3030] [6.0 SETK] **Fushat e interesit të posaçëm në mësimin e gjuhës angleze**
- [MCEL2030] [6.0 SETK] **Mësimi dhe përvetësimi i gjuhës angleze**
- [MCEL1040] [6.0 SETK] **Aspektet kulturore në ELT**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 2

- [MCEL1010] [6.0 SETK] **Metodika dhe praktika e mësimit të gjuhës së huaj**
- [MCEL3040] [6.0 SETK] **Analiza e nevojave dhe dizajnimi i lëndëve**
- [MCEL2041] [6.0 SETK] **Mësimi i gjuhës me ndihmën kompjuterit**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 3

- [MCEL1030] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [MCEL2040] [6.0 SETK] **Gjuha angleze për qëllime specifike**
- [MCEL2020] [6.0 SETK] **Ligjërimi i vokabularit**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 4

- [MCEL4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

Description of courses

Lëndë obligative

• Fushat e interesit të posaçëm në mësimin e gjuhës angleze

Lënda ofron një analizë të aspektit gjuhësor të çështjeve në ELT, si dhe të perspektivës kulturore / sociale. Në pjesën e gjuhësisë, përfshihen temat që kanë të bëjnë me aspektet sociale, kulturore dhe strukturore të kontaktit gjuhësor dhe ndërgjuhësisë dhe një hulumtim i hollësishëm i ndikimit të kontaktit gjuhësor në procesin e mësimit të gjuhës së huaj. Kjo lëndë e vlerëson rolin gjuhësor dhe faktorët e tjerë ekstra gjuhësore të cilët rregullojnë zhvillimin e brendshëm të sistemeve gjuhësore siç është roli i GJ1 (gjuha amtare e studentit) në procesin e zhvillimit të gjuhës GJ2 (gjuha qëllimore). Në anën kulturore / sociale, kjo lëndë është projektuar për t'u futur në polemika se me çfarë çështjes përballet sistemi i edukimit dhe trajnimit të mësimdhënësve sot. Tema aktuale në fushën e ELT janë hulumtuar dhe studentët janë inkurajuar për të vlerësuar se si kanë të bëjnë këto çështje me normat pedagogjike dhe praktikatat e edukimit gjuhësor. Kjo analizë do të shërbejë për të theksuar sfidat dhe pengesat me të cilat ballafaqohen mësimdhënësit në gjuhën e huaj dhe për të identifikuar çështjet relevante për mësimdhënësit në fushat e proceseve njohëse, arsim multikulturor dhe kritikatat pedagogjike.

• Mësimi dhe përvetësimi i gjuhës angleze

Lënda prezanton dhe shqyrton disa nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në përvetësimin e gjuhës së dytë (PGJD). Këtu përfshihet një ekzaminim i rolit që variablat gjuhësore, psikologjike dhe sociale luajnë në përvetësimin e të mësuarit e gjuhës së parë (GJ1) dhe të (GJ2), përvetësimin e gjuhës në dytë në veçanti. Teoritë e përvetësimit të gjuhës së dytë janë përfshirë si dhe janë diskutuar, duke i kushtuar vëmendje të veçantë implikimit të tyre në mësimin dhe të nxënies së gjuhës së dytë. Studentët janë të fokusuar në çështjet kyçe të përvetësimit të gjuhës së dytë: dallimet individuale në përvetësimin e gjuhës, roli i njohjes në përvetësimin e gjuhës së dytë, roli i ndërveprimit dhe konteksti social i përvetësimit të gjuhës së dytë; metodologjia kërkimore në përvetësimin e gjuhës së dytë.

• Aspektet kulturore në ELT

Qëllimi i lëndës është përgatitja e mësimdhënësve të ardhshëm për të ligjëruar në mënyrë efektive në mjediset dhe klasat multi-kulturore. Lënda përbëhet nga pesë tema: çka është kultura?; roli i gjuhës në kulturë; kultura e mësimdhënies; komunikimi ndërkulturor dhe ndërtimi i aftësive sociolinguistike.

• Metodika dhe praktika e mësimit të gjuhës së huaj

Lënda është dizajnuar për të inkurajuar mësuesit e gjuhës angleze për të përvetësuar një qasje të informuar dhe proces reflektues në mësimdhënien e tyre si gjuhë e huaj. Programi përfshin lexime mbi historinë e mësimdhënies së gjuhës angleze (ELT) nga mënyra tradicionale në praktikën 'mainstream' moderne, me qëllim që t'u ofrojë pjesëmarrësve një sfond solid në praktikën e mësimdhënies së gjuhës angleze (ELT). Temat e lëndës do të përfshijnë: klasifikimin e metodave dhe materialeve të mësimdhënies në klasë; përshtatjen dhe krijimin e materialeve mësimore; teknikatat dhe strategjitë e mësimdhënies, përdorimin e teknologjisë në mësimdhënien, menaxhimin klasë.

Studentët janë të inkurajuar që të nxjerrin në pah përvojat e tyre nga kontekstet ESL / EFL dhe të hulumtojnë në lidhje me teorinë dhe hulumtimin aktual.

- **Analiza e nevojave dhe dizajnimi i lëndëve**

Lënda orientohet drejt aspekteve praktike dhe teorike të mësimdhënies. Materialet mësimore do të përfshijnë: studime rasti, tekste teorike, pjesë nga tekstet shkollore, të dhënat e mbledhura nga studentët dhe hulumtuesit. Lënda përqendrohet kryesisht në ndikimin e analizës së nevojave për hartimin e lëndës: ndikimi në përcaktimin e objektivave dhe përmbajtjeve, ndikimi në pedagogji dhe metodologji. Metodatat e nxënies dhe vlerësimi do të përfshijnë: aktivitetet në grup, prezantimet dhe përgatitjen e një portofoli të materialeve mësimore.

- **Mësimi i gjuhës me ndihmën kompjuterit**

Meqë kompjuterët gjithnjë e më shumë integrohen dhe bëhen pjesë e pandashme e jetës sonë të përditshme, për mësimdhënësit e gjuhës është me rëndësi jetike që të kenë njohuri primare ta dhe ta dinë rolin të tyre në mësimin e gjuhës. Pa këto njohuri, është e vështirë për të bërë gjykime të shëndosha rreth faktit se si të integrohen kompjuterët në klasa të gjuhës në mënyrë që studenti duke mësuar të ndjehet më shumë i angazhuar, në mënyrë efikase dhe efektive. Lënda do të shërbejë si një bazë për mësimdhënësit e interesuar në zbatimin e teknologjisë në klasë për mësimin e gjuhës dhe më gjerë. Lënda prezanton teorinë dhe praktikatat aktuale të asistimit kompjuterik për të mësuarit të gjuhës (AKMGJ). Temat e lëndës përfshijnë historinë dhe parimet e AKMGJ-së, vlerësimin e softuerëve, projektimin dhe zhvillimin e kurseve të gjuhës nëpërmjet ueb-bazave, përdorimin e kompjuterëve në komunikim, hyper media dhe Corpus për mësimin e gjuhës. Përveç kësaj, do të futen edhe përdorimi i kompjuterëve në zhvillimin e aftësive gjuhësore të veçanta në fushën e leximit, shkrimit, komunikimit / shqiptimit. Lënda gjithashtu shqyrton teorinë aktuale të mësimin të gjuhës që nënvizojnë aplikacionet e AKMGJ-së.

- **Metodologjia e hulumtimit**

Një studim për kërkimin dhe marrjen e mostrave, duke përfshirë metodat e formimit të hipotezës, testimin dhe hulumtimin eksperimental. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet konceptit, teknikave dhe praktikës së metodologjisë sociale cilësore të kërkimeve shkencore. Përmes kësaj lënde, studentët do të mësojnë t'i zhvillojnë aftësitë hulumtuese që u duhen për të krijuar dhe për të zbatuar me sukses të plotë një projekt të konsiderueshëm kërkimor.

- **Gjuha angleze për qëllime specifike**

Gjuhë angleze për qëllime specifike (ESP) kërkon një qasje të përqendruar në mësimin e gjuhës angleze si gjuhë e huaj ose gjuhë e dytë. Ajo është projektuar për të përmbushur nevojat e studentëve të rritur të cilët kanë nevojë për të mësuar një gjuhë të huaj për përdorim në fushat e tyre specifike, si bie fjala në shkencë, teknologji, mjekësi dhe në të mësuarit akademik. Lënda është për studentët e diplomuar, studentët e huaj dhe profesionistët e gjuhës së huaj që dëshirojnë të mësojnë se si mund të hartojnë lëndë ESP dhe plan-programe në fusha specializimi të tilla si anglishtja e biznesit, inxhinieria dhe për qëllime akademike. Studentët janë futur në strategjitë e gjuhës angleze për qëllime specifike, për përshtatjen e materialeve mësimore dhe zhvillimin dhe teknikave të vlerësimit.

- **Ligjërimi i vokabularit**

Lënda është e dizajnuar që të ofrojë një pasqyrë të çështjeve pedagogjike në mësimdhënie dhe mësimnxënie të fjalorit të gjuhës angleze. Gjithashtu, lënda përfshin teknikat dhe aktivitetet në klasë për të mësuar aspekte të ndryshme të fjalorit të anglishtes dhe vlerësimin e materialit të mësimdhënies në këtë fjalor. Gjatë kësaj lënde studentët do të mësojnë rëndësinë e të diturit të një fjale dhe kompleksitetin e saj dhe do të motivohen për të mësuar fjalë të reja. Ata do të mësojnë se si të përdorin strategji të pavarura të mësimin të fjalëve dhe do të shqyrtojnë strategjitë mësimore për ndërtimin e gjerësisë dhe thellësisë së fjalorit të tyre. Studentëve do t'u mundësohet të mësojnë edhe lidhur me mënyrat e ndryshme të vlerësimit të fjalorit.

- **Punimi i magjistraturës**

Pas dhënies së provimeve, studenti mund të fillojë me procedurën e paraqitjes, hartimit dhe mbrojtjes publike të temës së magjistraturës. Studenti zgjedh mentorin, me udhëzimin e të cilit e përgatit aplikimin e tezës së magjistraturës. Aplikimi patjetër duhet të lejohet nga Këshilli mësimor shkencor i fakultetit. Pas punimit të versionit final të tezës së magjistraturës, Këshilli mësimor shkencor formon komision tre anëtarësh që përgatit raportin, me të cilin pranohet ose refuzohet teza e magjistraturës. Raporti pozitiv miratohet nga Këshilli mësimor shkencor dhe caktohet dita e mbrojtjes publike. Pas kryerjes me sukses të mbrojtjes studenti pajiset me diplomë - Magjistër nga mësimdhënia e gjuhës angleze.

Lëndë zgjedhore

- **Letërsia në mësimdhënien e gjuhës angleze**

Lënda hulumton qëllimin dhe vendin e letërsisë angleze në programin mësimor ELT. Ajo shqyrton marrëdhëniet në mes të mësimin të gjuhës dhe letërsisë dhe trajton çështjen se si letërsia mund të ndihmojë në arritjen e qëllimeve të mësimin të gjuhës. Lënda udhëzon studentët drejt një vlerësimi të teorive të ndryshme të letërsisë në ELT dhe kjo gjë duket qart në pyetjen më të gjerë se pse letërsia duhet të studiohet në një mjedis të universitetit si për studentët e GJ1 GJ2.

- **Analiza e diskursit**

Lënda merret me analizën gramatikore, strukturore dhe pedagogjike të teksteve (të shkruara ose të folura). Mbulon elementet e teksteve, si modelet gramatikore dhe stilet. Studentët do të njoftohen dhe do të përvetësojnë tema të rëndësishme në fushën e analizës tekstuale dhe të diskursit dhe në vazhdueshmëri do t'i forcojnë aftësitë thelbësore në mënyrën se si të shkruajnë, si të vlerësojnë dhe si të përmirësojnë tekstet e shkruara dhe të folura. Përveç kësaj, lënda do të aftësojë studentët për të pasur një qasje kritike ndaj një teksti, duke përfshirë shkrimin e tyre, vlerësimin e shkrimeve të studentëve të tjerë, dhënien e një feedback-u adekuat, si dhe të udhëheqin studentët e tyre të ardhshëm.

- **Kultura dhe mësimdhënia e gjuhës angleze si gjuhë e huaj**

Lënda fokusohet në modelet e përgjithshme, strategjitë dhe aftësitë që aplikohen për të mësuar kulturën si pjesë të mësimin të gjuhës. Qëllimi i lëndës është t'i ndihmojë studentët të kuptojnë dinamikën e kulturës, si brenda ashtu edhe jashtë orëve mësimore, por edhe të fillojnë zhvillimin e një vetëdijësimi dhe vlerësimi të bazës kërkimore që mbështesin praktikën aktuale në kulturën e mësimdhënies, duke studiuar shoqërinë amerikane dhe kulturën e saj. Lënda integron një koleksion të pasur të materialeve, të temave dhe qasjeve nga shumë fusha: jo vetëm studimin historik dhe letrar, por edhe atë vizual, si muzikologjia, filmi, media, antropologjia, dhe të tjera. Lënda thekson diversitetin multikulturor të shoqërisë amerikane, duke i kushtuar vëmendje të veçantë etnikumit, gjinisë, si dhe formave të tjera të ndryshimit shoqëror.

- **Seminar për shkrimin e tezës së magjistraturës**

Qëllimi i lëndës është që t'u mundësojë studentëve të shkruajnë tezën e magjistraturës në mënyrë efektive, të artikulojnë, dhe të qartë. Një student i cili përfundon këtë lëndë do të jetë në gjendje të hulumtojë materiale në mënyrë efikase dhe të shprehë konkluzionet e tij në mënyrë efektive nëpërmjet prozës akademike. Çdo ligjëratë do të shqyrtojë disa koncepte të rëndësishme që kanë të bëjnë me kërkime të avancuara akademike dhe të shkrimit. Do të përfshihen temat që vijojnë: shkrimi e një propozim hulumtimi, stili, plagjiatura dhe integriteti akademik, bibliografia dhe citatat, metodologjia kërkimore, si dhe propozim- recension.

- **Gramatika pedagogjike**

Qëllimi i lëndës është të ofrojë një model të integruar të përshkrimit të gjuhës që është projektuar për t'u përshtatur me nevojat e studentëve të gjuhës angleze. Modeli i përdorur organizon gramatikën nën tre tituj: strukturën, orientimin dhe modelimin, si dhe tregon marrëdhënien ndërmjet gramatikës dhe leksikut. Komponent i rëndësishëm i kësaj lënde është vetëdijësimi i studentëve për fenomenin e frazave leksikore: si janë organizuar, si mund të klasifikohen për qëllime mësimore dhe cila është rëndësia e tyre në ndërtimin e kompetencës komunikative. Studentët e suksesshëm do të bëhen më të vetëdijshëm se disa aspekte të ndryshme të gramatikës kërkojnë procese të ndryshme të mësimin dhe të strategjive të ndryshme mësimore.

- **Shkrimi pedagogjik**

Lënda fokusohet në qasjet dhe çështjet në mësimin e shkrimit të gjuhës së dytë. Studentët do të inkurajohen që të mendojnë në mënyrë kritike në lidhje me qasjet e ndryshme dhe të reflektojnë mbi besimet dhe praktikën e tyre në lidhje me shkrimin dhe mësimin e shkrimit. Lënda, jo vetëm që do të shqyrtojë teorinë mbizotëruese në mësimdhënien dhe shkrimin e gjuhës së dytë, por do të përqendrohet edhe në aspektet praktike të mësimin të shkrimit, duke përfshirë reagimet e mësimdhënësve dhe kolegëve, vlerësimin, audiencën, dizajnimin e planit mësimor, të materialeve dhe të detyrave për mësimin e shkrimit, si dhe huazimet tekstuale. Studentët, gjithashtu, do të inkurajohen t'i ndjekin hulumtimet e fushës dhe të mendojnë në mënyrë kritike në lidhje me to. Qëllimi i lëndës është të arrijë një ekuilibër në mes të njohurive teorike dhe praktike.

- **Retorika**

Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjimimin e shumë gjërave, por sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ ndërlidhet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qendrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari l përkufizon situatat e caktuara tipike të të folurit.

- **Multilingualizmi dhe multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termit: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplasat me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi shkencor. T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathtësi nga kapitujt e zgjedhur të aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. Zbatimi praktik i këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet për përpunimin statistikor të të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregohen studentëve elementet teknike nga lëmi i statistikës: organizimi, përpunimi, krahasimi përmes analizave dhe publikimi i të dhënave. T'u mundësojë studentëve të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi më të përparuara nga kapitujt e zgjedhur të avancuar të aplikacioneve për përpunimin statistikor të të dhënave. Zbatimi praktik i këtyre objektivave në përpunimin statistikor të të dhënave të marra nga pyetësorët, kontributet, studimet shkencore dhe dokumentet tjera.

- **Komunikimi profesional**

Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.

- **Tregu i punës**

Qëllimi kryesor i lëndës "Tregu i punës" është t'i pajisë studentët e studimeve të ciklit të dytë me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë të tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda "Tregu i punës" ka si mision t'u ofrojë dhe t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teoritë dhe politikat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale të cilat mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve që përfshihen në librin bazë nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv të studentit. Prandaj studenti, për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksion dhe seminar duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme që lidhen me tregun e punës.

- **Metodologjia e mësimdhënies**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me qasjet themelore dhe metodat e mësimdhënies. Pritet që studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për përdorim të mjeteve për mësimdhënie aktive. Gjithashtu, lënda ofron qasje ndaj zhvillimit, mësimdhënies dhe të nxënies si koncepte, si dhe ndaj normave themelore të cilat mësimdhënësve do t'u mundësojnë të ligjërojnë mbi zhvillimin e mendimit. Përmes kësaj lënde, studentët do të përfitojnë bazë teorike dhe strategji, me çka do të mund ta zhvillojnë të menduarit e tyre kritik, si dhe të menduarit kritik të studentëve.

- **Filozofia e shkencave shoqërore**

Kjo lëndë përfshin pajisjen e studentëve me informata që do t'u mundësojnë atyre përfitimin e diturive, shkathtësive dhe kompetencave në shkencat shoqërore, përfshirë metodologjinë e punës (sqarim, teoretizim, testim), aplikim të

filozofisë (në veçanti individualizmi kundrejt kolektivizmit), natyra e racionalitetit, si dhe historia e teorive dhe koncepteve. Ky modul ofron studim të avancuar të debateve aktuale lidhur me ontologjinë, metodologjinë dhe synimet e shkencave shoqërore. Lënda do të përqendrohet në çështjet qendrore të shkencave shoqërore: etno-metodologjia, evolucioni, fenomenologjia, racionaliteti, relativizmi, metodat shkencore, interpretime tekstuale. Rezultat e të mësuarit: Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Ta kuptojnë qëllimin e shkencave shoqërore si dhe dallimin në mes të të sqaruarit dhe të kuptuarit të sjelljes njerëzore. T'i sqarojnë qasjet e ndryshme në shpjegimin e shkencave shoqërore në krahasim me shkencat shoqërore, specifikat e të qenit qenie njerëzore dhe fenomenet sociale. T'i kuptojnë strukturat sociale, praktikat, normat institucionet etj. si dhe relacionet në mes individëve dhe strukturave më të gjera shoqërore. Ta sqarojnë mbështetjen jo vetëm në fakte për individët dhe gjendjet e tyre mentale, por gjithashtu edhe rastet në të cilat fenomenet shoqërore nuk mundet të sqarohen përmes sjelljeve individuale.

- **Menaxhimi i projekteve**

Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; Të strukturojnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e optimizimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i prezantojë teknikat e modelimit dhe të optimizimit me qëllim të aftësisë të studentëve në zhvillimin e modeleve të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve reale në lëmin e shkencave kompjuterike. Në mes tjerash kjo lëndë ka për qëllim ta analizojë rëndësinë e faktorizimit matricor si një mjet shumë i rëndësishëm që ofron modalitete për optimizimin e zgjidhjes së algoritmeve të ndryshme numerike me interes bazik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga sfera e shkencave kompjuterike. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të kenë mundësi t'i mësojnë teorinë bazike të optimizimit edhe metodat për caktimin e optimumit. Do të analizohen metodat e ndryshme të optimizimit sikurse që është simpleks metoda, problemi i dualitetit si dhe sensitiviteti i problemeve të programimit linear. Qëllimi, po ashtu, është analiza e zbatimit kompjuterik të secilit problem të analizuar duke ofruar edhe modelin përkatës për optimizim.

- **Çështjet etike dhe e drejta në teknologjitë e informacionit (TI)**

Qëllimet e lëndës: Të zhvillojë kuptueshmërinë për gjendjen reale në relacionet mes kompjuterëve, ndryshimeve të teknologjisë, shoqërisë dhe ligjit; Të vejë në pah rolin e fuqishëm që kompjuterët dhe profesionistët e kompjuterëve kanë në shoqërinë e teknologjisë; Të ofron të kuptuarit e çështjeve legale që janë relevante për lëminë e kompjuterizimit; Të ofron të kuptuarit e koncepteve etike që janë me rëndësi për shfrytëzuesit e kompjuterëve dhe profesionistët; Të kontribuon në arritjen e eksperiencës së nevojshme në shqyrtimin e çështjeve etike dhe zgjidhjen e dilemave etike.

- **Mbrojta e të drejtave të njeriut**

Qëllimi i kësaj lënde është: të njoftohen studentët me konceptin e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, ndikimin e tyre në krijimin e politikave nacionale, të nxiten studentët të mendojnë në mënyrë kritike për raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale, të vetëdijësohen për ngjarjet aktuale ndërkombëtare, si ndikojnë ato në jetën e përditshme të njerëzve në botë, ti nxisë studentët ta japin kontributin e tyre në sferën e përgatitjes së ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me shpresë se ata që sjellin vendime do i marrin parasyshtë në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave shtetërore.